- **Margerita Topalli**, Ekonomiste e Lartë në Departamentin e Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë, ofroi analiza mbi ndikimin e politikave klimatike në stabilitetin financiar.
- **Alma Lulja**, Zëvendës-Koordinatorë Rajonale e një projekti në BERZH, theksoi rolin e institucioneve ndërkombëtare në promovimin e financave të gjelbra.
- **Mirela Kamberi**, Koordinatorë Kombëtare e Komunikimeve Kombëtare për IPCC nga UNDP, theksoi nevojën për politika afatgjata për përballimin e risqeve klimatike.
- **Anisa Kume**, Eksperte për Risqet Fiskale Klimatike dhe pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë, solli një perspektivë akademike mbi ndikimet fiskale të ndryshimeve klimatike dhe vlerësimin e risqeve fiskale që burojnë nga ndryshimet klimatike dhe fatkeqësitë natyrore.
- **Xhoana Hudhra**, Menaxhere Sektori në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, prezantoi politika që promovojnë sipërmarrjen dhe qëndrueshmërinë.
- **Admira Mlika**, Drejtoreshë e Bankës Korporative dhe të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT), theksoi sfidat dhe mundësitë me të cilat përballlet sektori privat në përballimin e krizës klimatike.
- **Dorian Pashaj**, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Qëndrueshëm në ProCredit Bank Albania, ndau përvojën e institucionit në zbatimin e kriterëve të qëndrueshmërisë në praktikën e kreditimit.
- **Rozeta Bejko** dhe **Daniela Ndrejaj**, përfaqësuese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), ofruan perspektiva rregullatore dhe mbikëqyrëse mbi financat e qëndrueshme.



Nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, morën pjesë gjithashtu një sërë studiuesish dhe pedagogësh: **Elona Pojani, Perseta Grabova, Matilda Tola, Klejda Gabeshi dhe Mariel Frroku**, të cilët ndanë ekspertizën e tyre në ekonomi, financa dhe politika klimatike. Tryeza përfshiu gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve nga Fakulteti i Ekonomisë, me synimin për të inkurajuar përfshirjen e brezit të ri në debatet mbi sfidat klimatike dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Raporti i tryezës

Në vijim janë paraqitur diskutimet e veçuara dhe kontributet e secilit pjesëmarrës në tryezë. Më pas një seksion rekomandimesh ka përmbledhur rezultatet kryesore të tryezës.

Diskutimet e pjesëmarrësve

Zj. Margarita Topalli

Gjatë sesionit të parë, përfaqësuesi i Bankës së Shqipërisë vuri në dukje se risqet klimatike janë tashmë të konsideruara si risqe financiare, duke u përfshirë gradualisht në qasjet strategjike të institucionit. Në këtë kuadër, theksoi:

- Qasja afatgjatë ndaj risqeve klimatike është e domosdoshme. Megjithatë kjo është ende një temë e re për një bankë qendrore, është bërë përpjekje për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse, në përputhje me përvojën e rrjeteve ndërkombëtare si NGFS (Network for Greening the Financial System) dhe praktikat e Bashkimit Evropian.
- Në bashkëpunim me IFC dhe World Bank, Banka e Shqipërisë ka zhvilluar një pyetësor për sektorin bankar, me qëllim matjen e ndërgjegjësimit mbi risqet klimatike dhe tranzicionin drejt qëndrueshmërisë.
- Është në proces transpozimi Direktiva për Financat e Qëndrueshme të BE-së, por ende mungon një taksonomi kombëtare, çka vështirëson harmonizimin e qasjes mes institucioneve dhe sektorit privat.
- Janë kryer vlerësime paraprake për ekspozimin e bankave ndaj risqeve klimatike, si dhe është hartuar një udhëzues për sektorin bankar, që i nxit institucionet financiare të raportojnë mbi ekspozimet e tyre përmes skenarëve dhe stres-testeve.
- Një studim i përbashkët me Bankën Botërore ka analizuar risqet e tranzicionit, përfshirë ndikimin e vendosjes së një takse karboni mbi Prodhimin e Brendshëm Bruto (GDP) dhe cilësinë e portofolit të bankave (NPLs).
- Vështirësia kryesore lidhet me mungesën e të dhënave të strukturuar, ndaj është propozuar krijimi i një "green dashboard" për të mbledhur dhe vizualizuar informacionin në mënyrë të qëndrueshme.



Co-funded by the
European Union

"Funded by the European Union. Views and opinions expressed are however those of the author(s) only and do not necessarily reflect those of the European Union or EACEA. Neither the European Union nor the granting authority can be held responsible for them"

- Në janar 2025, është planifikuar nënshkrimi i një marrëveshjeje me Bankën Evropiane të Investimeve (EIB), që do të shënojë fillimin e punës për hartimin e një taksonomie kombëtare shqiptare. Procesi do të nisë me sektorë pilot dhe do të mbikëqyret nga një komitet teknik ndërinstytucional.

Objektivat për të ardhmen përfshijnë:

- Përgatitjen e fazës së dytë të Strategjisë për Risqet Klimatike deri në vitin 2025;
- Fokusi i kësaj faze do të jetë kuantifikimi i risqeve fizike, duke avancuar më tej përdorimin e stres-testimeve për risqet fiskale;
- Zgjerimi i analizës jo vetëm për ndryshimet klimatike, por edhe për sektorë të tjerë me impakt, si blu economy (ekonomia detare).

Këto zhvillime tregojnë një angazhim të qartë institucional për të integruar risqet klimatike në stabilitetin financiar dhe për të kontribuar në tranzicionin drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe rezistente ndaj klimës.

Zj. Egis Zaimaj

Në ndërhyrjen e saj, theksoi disa çështje kyçe që lidhen me perceptimin dhe sfidat praktike të tranzicionit të gjelbër në Shqipëri. Ai theksoi se, sipas të dhënave të mbledhura nga takimet me bizneset dhe analizat primare:

- Niveli i informimit dhe ndërgjegjësimit në sektorin privat mbetet i ulët – tranzicioni drejt qëndrueshmërisë perceptohet më shumë si kërcënim dhe kosto e shtuar sesa si mundësi zhvillimi ekonomik.
- Në këtë fazë të hershme, sfida më e madhe është mungesa e kapaciteteve teknike dhe njerëzore – është i nevojshëm investimi në kapital njerëzor dhe ekspertizë për matjen dhe analizën e rreziqeve klimatike.
- Ajo theksoi se qasja më kosto-efektive është mitigimi (parandalimi i dëmeve përmes masave proaktive) sesa adaptimi pas ndodhjes së fenomeneve.

Për Green Budgeting dhe Politikat Fiskale

Zj. Zaimaj theksoi se green budgeting ka nisur të marrë vëmendje serioze, megjithëse:

- Deri në vitin 2010, ishte ende një praktikë e re në BE dhe karakterizohej nga heterogjeniteti i madh ndërmjet vendeve.
- Deri në 2023, janë ndërmarrë hapa pozitivë për integrimin e objektivave klimatike në proceset buxhetore përmes një strategjie që përfshin masa, objektiva dhe harmonizimin e politikave fiskale me objektivat mjedisore.

- Dy mjete kryesore që po përdoren janë subvencionet dhe nxitja e investimeve të qëndrueshme, veçanërisht në sektorët e energjisë dhe transportit.

Ajo përmendi disa shembuj konkretë të politikave dhe projekteve në zhvillim:

- Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2030, i cili fokusohet tek energjia, transporti dhe gradualisht turizmi.
- Elektrifikimi i transportit publik në Tiranë me mbështetje nga BE, KfW dhe WB – përfshirë infrastrukturën për taksitë elektrike, ku tashmë mbi 60% e flotës së taksive janë elektrike.
- Diversifikimi i burimeve të energjisë elektrike nga një model 100% hidro në një miks më të balancuar me energji solare dhe eolike, si përgjigje ndaj pasigurisë klimatike.

Ai vlerësoi edhe politikat mbështetëse për konsumatorët:

- Subvencione deri në 70% (duke shkuar drejt 100%) për instalimin e paneleve diellore, si një mekanizëm i drejtpërdrejtë për të nxitur përdorimin e burimeve të qëndrueshme në nivel familjar dhe biznesi.

Rëndësia e Ndryshimit të Sjelljes

Zj. Zaimaj theksoi se tranzicioni i suksesshëm kërkon ndryshim të sjelljes dhe rritje të ndërgjegjësimit, si nga bizneset, ashtu edhe nga konsumatorët, jo vetëm për të kuptuar kostot, por sidomos për të identifikuar përfitimet që vijnë nga investimet në teknologji dhe praktika të gjelbra.

Në përfundim, ajo nënvizoi se politikat publike janë duke u zhvilluar në drejtimin e duhur, por përfshirja aktive dhe informimi i sektorit privat mbetet një faktor kritik për përshpejtimin e tranzicionit dhe për minimizimin e perceptimit të “kostos” në favor të identifikimit të mundësive afatgjata.

Zj. Esida Bujupi

Përfaqësuesja e Bankës Botërore nënvizoi rolin kyç të institucionit në mbështetjen e ekonomisë shqiptare dhe sistemit financiar përballë risqeve të lidhura me ndryshimet klimatike. Ajo strukturoi kontributin e WB në tre drejtime kryesore:

Raporti për Klimën dhe Zhvillimin e Shqipërisë (2024) – publikuar pr herë të parë këtë vit dhe planifikuar të bëhet pjesë e publikimeve periodike të Bankës. Përfaqëson produktin kryesor analitik i Bankës Botërore mbi klimën. CCDR është konceptuar për të ndihmuar në marrjen e vendimeve strategjike, për të identifikuar risqet klimatike që mund të çenojnë arritjet e zhvillimit dhe për të propozuar rrugë drejt një rritjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe të qëndrueshme ndaj ndryshimeve klimatike.

Raporti thekson nevojën për investime strategjike në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për të zbutur ndikimet dhe për të stabilizuar balancat fiskale. CCDR për Shqipërinë nënvizon rolin thelbësor të sektorit financiar në përballimin e cenueshmërisë klimatike dhe në avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ai bën thirrje për integrimin e faktorëve klimatikë në sistemin bankar tradicional të Shqipërisë, përmes:

- forcimit të menaxhimit të riskut dhe mundësitë të financave të gjelbra;
- përmirësimit të kapaciteteve institucionale, kuadrit politik dhe mjeteve të investimit;
- mbështetjes së objektivave klimatike të vendit dhe ndërtimit të qëndrueshmërisë afatgjatë.

Diagnoza për Financat e Gjelbra në Shqipëri (2022). Diagnostikimi i Financave të Gjelbra për Shqipërinë vlerëson gatishmërinë e sektorit financiar shqiptar për të përballuar risqet që lidhen me ndryshimet klimatike dhe për të rritur investimet e gjelbra.

1. Risqet Fizike Klimatike:

- Më shumë se 30% e portofolit të kredive bankare është i përqendruar në sektorë të ndjeshëm ndaj klimës, si bujqësia, energjia dhe ndërtimi.
- Bujqësia përbën rreth 20% të PBB-së dhe punëson mbi 36% të fuqisë punëtore, por merr vetëm rreth 1.59% të kredisë bankare ⇒ ekspozim i ulët direkt ndaj fermerëve. Megjithatë, bankat kanë ekspozim të lartë indirekt për shkak të rolit makroekonomik të bujqësisë (të ardhura, punësim, furnizimi ushqimor).
- Mbulesa e sigurimeve është e kufizuar: vetëm 5% e policave mbulojnë përmbytjet dhe vetëm 0.2% rrëshqitjet e tokës. Rreth 25% e portofolit të sigurimeve jo-jetë është i ekspozuar ndaj katastrofave natyrore, kryesisht përmes sigurimit të pronës dhe automjeteve.
- 74% e kredidhënies është e përqendruar në Tiranë, gjë që amplifikon risqet lokale.

2. Risqet e Tranzicionit:

- Bankat janë të ekspozuara ndaj sektorëve me intensitet të lartë karbonik dhe të varur nga tregtia me BE-në (rreth 35% e tyre, si ndërtimi, prodhimi industrial etj.).
- Politikat e reja klimatike të BE-së (p.sh. Mekanizmi i Rregullimit të Karbonit në Kufij – CBAM) mund të dëmtojnë eksportuesit dhe të rrisin riskun e kreditit për huamarrësit e prekur.
- Ndryshime të papritura në rregullore ose teknologji (p.sh. çmimi i karbonit, adoptimi i energjisë së pastër) mund të cenojnë fitimin e klientëve dhe performancën e kredive.

3. Mangësitë Institucionale:

- Deri së fundmi, Banka e Shqipërisë dhe AMF nuk kishin kapacitete për testim të stresit klimatik – asistencë teknike është ofruar.
- Kërkesat për raportimin e treguesve ESG janë të kufizuara.
- Mungojnë sistemet për të gjurmuar emetimet e kompanive apo për të identifikuar vendndodhjet e rrezikut financiar nga ndryshimet klimatike.

Mbështetja për Politikën Fiskale të Gjellbra. WB ka ofruar asistencë teknike për Bankën e Shqipërisë në lidhje me stres-testet dhe përgatitjen e fazës së dytë të Strategjisë Klimatike të saj. Ka mbështetur rritjen e taksës së karbonit si politikë fiskale për tranzicionin klimatik, përmes asistencës buxhetore. Është realizuar analizë mbi ndikimin e kësaj takse në ekonominë kombëtare, në rritjen e të ardhurave publike dhe ndikimin e saj te grupet më të cënueshme të shoqërisë.

Green Budgeting dhe Performanca Fiskale Klimatike. WB ka ndihmuar institucionet shqiptare të vendosin indikatorë performancë klimatike në buxhet. Parashikohet që vendi të kalojë në një sistem të plotë të buxhetimi të gjelbër brenda 5 viteve, por fazat e para janë tashmë në zbatim.

Financimi i Risqeve nga Fatkeqësitë (Disaster Risk Financing). Është theksuar nevoja për kuantifikimin e impaktit ekonomik të fatkeqësive dhe vendosjen e kontigjencave fiskale në buxhet, për të reaguar ndaj krizave. Banka Botërore po asiston Ministrinë e Financave në vlerësimin e ekspozimit fiskal ndaj fatkeqësive natyrore, në hartimin e buxheteve të kontigjencës, si dhe në eksplorimin e instrumenteve të sigurimit dhe bashkimit të risqeve. Gjithashtu, po mbështet integrimin e Financimit të Riskut nga Fatkeqësitë (DRF) në etiketimin buxhetor dhe në deklaratat e riskut fiskal, me qëllim përmirësimin e përgatitjes financiare paraprake. Për këtë, kërkohet: Legjislacion i qartë; Kapacitete institucionale të dedikuara; Integrim i modeleve të parashikimit financiar për katastrofa natyrore.

Mbështetja Financiare dhe Asistencë Teknike. Banka Botërore po mbështet në mënyrë aktive gatishmërinë financiare dhe fiskale të Shqipërisë përmes disa iniciativave në vijim:

- Plani i Veprimit për Klimën i Bankës së Shqipërisë (2023–2025): Hartuar në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë për të udhëzuar integrimin e risqeve klimatike në mbikëqyrjen financiare.
- Rishikimi i Financave Publike (2024): Analizon shpenzimet publike të lidhura me klimën, taksimin mjedisor dhe hapat drejt buxhetimit klimatik.
- Huadhënia për Politikën e Zhvillimit (DPL): Mbështet reformat që lidhen me taksimin e karbonit, etiketimin klimatik të buxhetit dhe raportimin jo-financiar nga ndërmarrjet shtetërore.
- Asistencë Teknike: Mbështetje e vazhdueshme për Ministrinë e Financave në menaxhimin e risqeve fiskale, etiketimin e risqeve nga fatkeqësitë dhe raportimin fiskal të lidhur me klimën.

Përfundimisht, përfaqësuesja e Bankës Botërore adresoi:

- Krijimin e një qasjeje të koordinuar për risqeve klimatike;
- Zgjerimin e mbështetjes ndërkombëtare për Shqipërinë përmes fondeve dhe asistencës teknike;
- Ndërtimin e një strategjie të qëndrueshme për financat e gjelbra, me angazhimin e të gjithë aktorëve – qeveri, sektor privat, dhe institucione financiare.

Zj. Anisa Kume

Në kuadër të ekspertizës së saj në qëndrueshmërinë fiskale, Zj. Kume parashtroi një seri informacionesh për panelin. Agjenda klimatike ka filluar të reflektohet në strategjitë fiskale dhe institucionale të Shqipërisë, veçanërisht pas tërmetit të vitit 2019 dhe përmbytjeve të përsëritura. Përmes Strategjisë Afatmesme të Financave Publike 2023–2030 është përfshirë për herë të parë buxheti klimatik si objektiv institucional. Kjo përfshin zhvillimin e një metodologjie për buxhetim të ndjeshëm ndaj klimës dhe pilotimin në disa institucione buxhetore. Për më tepër, bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë, si UNDP, GIZ dhe Green Climate Fund, ka sjellë në zbatim projekte si AlbAdapt dhe RESEAL II, të cilat rrisin ndërgjegjësimin dhe kapacitetet për të adresuar efektet e klimës në nivel lokal. Ky orientim tregon qartë se financat publike dhe planifikimi fiskal po e inkorporojnë gjithnjë e më shumë dimensionin klimatik.

Diskutimin e saj, Zj. Kume e organizoi në disa aspekte:

1. Panorama

Shqipëria është ndër vendet më të ekspozuara në Europën Juglindore ndaj rreziqeve natyrore – përmbytje, zjarre, tërmete – që ndodhin gjithnjë e më shpesh dhe me intensitet më të lartë. Vetëm gjatë vitit 2024, vendi përjetoi 168 zjarre që përfshinë mbi 46 mijë hektarë, duke rritur rrezikun për përmbytje dhe erozion. Paralelisht, aktiviteti sizmik është i vazhdueshëm, ndërsa përmbytjet janë një fenomen i përvitshëm.

Këto dukuri, përveç kostove njerëzore dhe mjedisore, krijojnë presione të drejtpërdrejta mbi buxhetin e shtetit – që nga shpenzimet emergjente, deri te rindërtimi, subvencionet dhe humbjet fiskale në nivel vendor.

2. Kostoja reale dhe boshllëku financiar

Sipas Bankës Botërore, humbjet e pritshme vjetore nga katastrofat natyrore në Shqipëri kapin rreth 140 milionë USD. Sipas FRS 2024, nuk ekziston ende një fond i dedikuar, nuk ka një skemë sigurimi shtetëror, dhe përdorimi i instrumenteve të ndarjes së riskut është minimal.

Financimi ndodh në mënyrë ad hoc, përmes rishikimeve buxhetore ose mbështetjes direkte për sektorë të ekspozuar si energjia dhe bujqësia.

3. Hapat e ndërmarra: përfshirja në kuadër institucional dhe buxhetor

Ka progres domethënës:

- Në vitin 2023 nisi publikimi i Deklaratës së Risqeve Fiskale (FRS), ndërsa në versionin 2024 përfshihet për herë të parë një kapitull i dedikuar për fatkeqësitë natyrore.
- Është ngritur Baza Kombëtare e të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë, që shërben si referencë për analizën fiskale dhe vendimmarrjen.
- Në Strategjinë e Financave Publike 2023–2030, janë përfshirë dy masa kyçe:
 - o Buxhetimi klimatik, që po pilotohet në disa sektorë;
 - o Krijimi i Këshillit Fiskal, si institucion i pavarur që do të analizojë qëndrueshmërinë fiskale, përfshirë rreziqet klimatike (i planifikuar për vitin 2026).

4. Ligji për sigurimin nga tërmetet – një hap drejt ndarjes së rrezikut

Në vijim të rekomandimeve të Bankës Botërore (CEM 2021), është hartuar një projektligj për sigurimin e detyrueshëm të banesave ndaj tërmeteve, i cili u publikua për konsultim në vitin 2023. Drafti parashikon një primë simbolike dhe krijimin e një Fondi Kombëtar për Tërmetet.

Gjatë vitit 2024, u diskutua një variant alternativ me stimuj tatimorë, ku qytetarët që sigurojnë banesën përfitojnë zbritje në tatimin mbi të ardhurat. Megjithatë, asnjë nga variantet nuk është miratuar ende.

Ky proces dëshmon një përpjekje për kalimin drejt qasjes ex-ante, me synim ndarjen e barrës financiare dhe rritjen e qëndrueshmërisë sociale dhe fiskale.

5. Sfidat që mbeten

Sfidat janë të njohura:

- Qasje dominuese ex-post, me varësi të madhe nga fondi rezervë;
- Mungesa e instrumenteve të sigurimit soveran, obligacioneve katastrofike apo fondeve të posaçme;
- Kapacitete të kufizuara në nivel vendor për vlerësimin dhe raportimin e dëmeve;
- Mungesa e ndërlikohjes funksionale midis buxhetit dhe politikës klimatike.

6. Mbështetja ndërkombëtare dhe iniciativat e reja

Në kuadër të bashkëpunimit me UNDP, po zbatohet projekti RESEAL II, i cili pas fazës pilot në Qarkun Fier, do të zgjerohet në Qarkun Shkodër dhe 5 bashkitë e saj. Qëllimi është hartimi i kuadrit rregullator lokal për menaxhimin e riskut, si dhe forcimi i kapaciteteve operationale për reagim në nivel vendor.

Gjithashtu, në dhjetor 2024 u nënshkrua marrëveshja për programin AlbAdapt, një grant 6-vjeçar prej 4 milionë euro nga Green Climate Fund, i bashkëfinancuar nga qeveria shqiptare me 2.5

milione euro. Ky program do të mundësojë Sistemin Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm për shumë rreziqe, duke ofruar një qasje të re në veprimet parandaluese të bazuara në parashikime.

Z. Dorian Pashaj

Në emër të ProCredit Bank, Z. Pashaj ndau përvojën e bankës në lidhje me integrimin e riskut klimatik dhe financimin e qëndrueshëm. Ai theksoi se:

- Vlerësimi i riskut klimatik është tashmë një komponent i pandarë i analizës së riskut kreditor, që zbatohet për të gjithë portofolin e kredive të bankës.
- Fokusi i bankës nuk është vetëm tek risqet, por edhe tek mundësitë që sjell tranzicioni energjetik, në përputhje me objektivat e BE për një ekonomi me zero emetime neto.

Investimet dhe Portofoli i Gjelbër

ProCredit ka ndjekur një qasje të qëndrueshme që prej vitit 2012, kur ka implementuar një Sistem të Menaxhimit Social dhe Mjedisor, i ndërtuar mbi tre shtylla kryesore:

1. Reduktimi i gjurmës ekologjike së vetë bankës;
2. Vlerësimi i ndikimit klimatik të investimeve të klientëve;
3. Zhvillimi i produkteve të financimit të gjelbër.

Deri më sot:

- 20% e portofolit të kredisë së bankës është klasifikuar si “i gjelbër”, sipas kriterëve të përcaktuara nga BERZH (EBRD).
- Investimet e financuara përfshijnë: panele diellore, makina elektrike, sisteme për efikasitet energjetik, ruajtje të cilësisë së ajrit, dhe reduktim të konsumit të ujit.

Angazhimet Ndërkombëtare

- ProCredit është pjesë e Net Zero Banking Alliance, dhe ka vendosur objektiva të matshëm afatshkurtër dhe afatgjatë, jo vetëm për operacionet e veta (Scope 1 dhe 2), por edhe për portofolin e klientëve (Scope 3).
- Gjithashtu, bankës i është bashkuar nisma Sustainable Banking and Development Initiative (SBDI) dhe Finance Leadership on Plastics, me qëllim reduktimin e plastikës dhe promovimin e qasjeve të qëndrueshme në sektorin financiar.

Partneritete dhe Mbështetje për Bizneset

- Z. Pashaj theksoi se ky angazhim afatgjatë është mundësuar edhe përmes mbështetjes nga aksionerë si BERZH, jo vetëm me eksperiencë, por edhe përmes granteve të dedikuara për bizneset që synojnë investime të qëndrueshme.

- Tryezat e diskutimit janë të domosdoshme për të rritur ndërgjegjësimin, si në sektorin bankar ashtu edhe në atë të biznesit dhe konsumatorit, duke ndihmuar për të shndërruar sfidat klimatike në mundësi konkrete investimi.

Në përmbyllje, ai nënvizoi rëndësinë e qasjes proaktive nga sektori bankar për të mbështetur transformimin e ekonomisë shqiptare drejt qëndrueshmërisë dhe neutralitetit klimatik.

Zj. Admira Mlika- BKT

Znj. Mlika, përfaqësuese e Banka Kombëtare Tregtare (BKT), ndau perspektivën e institucionit lidhur me sfidat dhe mundësitë që sjell integrimi i komponentit klimatik në sistemin bankar shqiptar. Ajo vuri në dukje se:

- Sistemi financiar dhe bankar është i ekspozuar ndaj risqeve klimatike, dhe kjo kërkon një qasë të integruar përtej aftësisë paguese të klientëve.
- Kredithënia në Shqipëri përbën rreth 33% të totalit të depozitave, çka tregon për një nivel ende të ulët të ndërmjetësimit financiar dhe një potencial të madh për zhvillim, nëse shoqërohet me mekanizma të qëndrueshëm dhe të drejtë të riskut.

Ndërgjegjësimi dhe Produktet Favorizuese

- BKT po përpiqet të rrisë ndërgjegjësimin e bizneseve për investime të qëndrueshme, duke theksuar rëndësinë e kthevshmërisë afatgjatë dhe përfitimeve që ato sjellin – jo vetëm në aspektin mjedisor, por edhe financiar.
- Banka ka zhvilluar produkte të posaçme kredie, me kushte dhe norma interesi të favorizuara për investime që lidhen me energjinë e rinovueshme dhe bujqësinë – sektorë strategjikë për ekonominë e vendit dhe për agjendën e gjelbër.

Sfidat e Sigurimeve dhe Vlerësimi i Riskut

- Një nga sfidat kryesore të evidentuara është mungesa e mbulimit të kolateraleve me sigurime të detyrueshme.
 - Kolateralet e siguruara rezultuan më pak problematike në rastin e fatkeqësive.
 - Sigurimet vullnetare nuk kanë funksionuar mjaftueshëm për të mbrojtur asetet e individëve dhe bizneseve – si pasojë e nivelit të ulët të ndërgjegjësimit.
- BKT ka realizuar një vlerësim të ekspozimit të portofolit të saj, ku rezulton se sektori i ndërtimit është ndër më të ekspozuarit ndaj riskqeve klimatike – megjithatë, ky ekspozim vlerësohet në nivele të moderuara për momentin.

Rekomandime dhe Rruga përpara

- BKT vlerëson se është thelbësore të punojmë më shumë për të rritur ndërgjegjësimin, më shumë sesa të kërkohej rritje e menjëhershme e nivelit të kreditimit.
- Pavarësisht përparimeve në produktet për bizneset, produktet e kredive për individët që synojnë sjellje të qëndrueshme apo investime mjedisore, ende kanë shumë vend për zhvillim.

Në përmbyllje, znj. Mlika theksoi se bankat duhet të shohin tej analizës klasike të riskut dhe të përfshijnë riskun klimatik si komponent kryesor në vlerësimin e klientëve, njëkohësisht duke arsimuar klientët për përfitimet e financimit të gjelbër.

Z. Mariel Frroku

Z. Mariel Frroku, ekspert fiskal, solli në vëmendje dimensionin e financimit të politikave klimatike në kontekstin e menaxhimit të financave publike, duke ofruar një analizë realiste mbi sfidat dhe përparimin aktual në këtë drejtim.

- Ai theksoi se, menaxhimi i financave publike në funksion të qëllimeve klimatike është një proces që tashmë ka nisur, dhe kjo është një arritje pozitive në vetvete, pavarësisht ritmit të ngadaltë.
- Zbatimi i politikave klimatike shpesh vonohet, jo për mungesë vullneti, por për shkak të faktorëve praktikë që mbeten prioritarë për institucionet publike (si presioni mbi buxhetin, emergjencat sociale dhe administrative).
- Aktualisht, është e vështirë që institucionet publike t'i japin përparësi financimit të masave klimatike, pasi mungon presioni institucional dhe ndërgjegjësimi i brendshëm.

Z. Frroku vlerësoi disa politika ekzistuese të suksesshme, si Nisma për “green taxi” apo subvencionet për panelet diellore. Megjithatë, ai theksoi se këto janë ndërhyrje të izoluar, që duhet të diversifikohen dhe përfshijnë më shumë sektorë e përfitues. Duhet të kalohet në një fazë të dytë me ndërhyrje më të mëdha dhe substanciale, që mund të prodhojnë impakt të qëndrueshëm ekonomik dhe social.

Në diskutimin mbi financimin e Politikave të Gjelbra, Z. Frroku diskutoi se resurset aktuale janë të kufizuara, veçanërisht në mungesë të fondeve të dedikuara ose instrumenteve financiare për rreziqet klimatike. Ai theksoi nevojën për identifikim të qartë të burimeve të brendshme dhe të jashtme të financimit; përdorim më efektiv të fondeve të BE-së dhe institucioneve ndërkombëtare; integrim të objektivave klimatike në planifikimin buxhetor dhe menaxhimin e shpenzimeve publike.

Në përfundim, z. Frroku theksoi se ndërgjegjësimi institucional dhe qytetar mbetet një hallkë e dobët, e cila duhet përforcuar për të çuar përpara agjendën e financave të qëndrueshme në Shqipëri. Ai sugjeroi që politikat e ardhshme të strukturohen me qartësi, përfshirje dhe

mbështetje të qëndrueshme financiare, përndryshe progresi do mbetet sporadik dhe i varur nga momentumet politike.

Zj. Alma Lulja ,

Përfaqësuesja e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ndau perspektivën mbi sfidat dhe mundësitë që lidhen me financimin e produkteve të energjisë së rinovueshme dhe efikasitetit energjetik përmes platformës GEFF – Green Economy Financing Facility.

Sfidat Kryesore

- Një nga vështirësitë më të mëdha lidhet me mungesën e qartësisë në definimin e kriterëve se çfarë konsiderohet si “produkt i gjelbër” (green). Mungesa e një kuadri kombëtar apo udhëzues të qartë e bën më të vështirë identifikimin dhe klasifikimin e produkteve të rinovueshme.
- Nga ana tjetër, individët dhe qytetarët shpesh nuk e dinë ku t’i gjejnë këto produkte, si t’i verifikojnë apo cilat janë burimet e financimit në dispozicion për to.

Zgjidhja e orfruar përmes Platformës GEFF

- GEFF (Green Economy Financing Facility) është një platformë e mbështetur nga BERZH, e cila ofron një rrjet të strukturuar për financimin dhe përfitimin nga teknologjitë e gjelbra për individët.
- Deri më sot, janë regjistruar mbi 3000 produkte “green” në këtë platformë, të cilat ofrohen nga tregtarë shqiptarë të certifikuar.
- GEFF ka marrëveshje me tre banka partnere në Shqipëri – ProCredit Bank, Intesa Sanpaolo Bank dhe Union Bank – të cilat:
 - Ofron kredi të gjelbra për individët;
 - Përfshijnë një komponent granti, që ofrohet nga donatorët e programit;
 - Pas kryerjes së investimit, individët aplikojnë online për grantin, i cili zakonisht mbulon 20% të shumës së investimit.
- Regjistrimi i tregtarëve në platformë është falas, me qëllim që të rritet transparenca, vizibiliteti dhe konkurrenca në tregun e produkteve të qëndrueshme.

Znj. Alma theksoi se GEFF ofron një model praktik, transparent dhe të strukturuar për të ndihmuar qytetarët të investojnë në mënyrë të qëndrueshme, ndërkohë që ndihmon tregun të zhvillojë produkte cilësore dhe të verifikuara. Sidoqoftë, ajo nënvizoi se edukimi i konsumatorëve dhe promovimi i platformës janë thelbësore për ta kthyer këtë mjet në një instrument real për tranzicionin e gjelbër në Shqipëri.

Zj. Xhoana Hudhra

Znj. Xhoana Hudhra, përfaqësuese e MEKI dhe koordinatorë kombëtare për raportet OECD në Shqipëri, ndau përpykjet institucionale dhe sistemike të ndërmarra në drejtim të politikave mjedisore dhe financimit të gjelbër, si dhe rolin e Shqipërisë në proceset e monitorimit ndërkombëtar.

Performanca në Raportet Ndërkombëtare – OECD

Znj. Hudhra theksoi se Shqipëria ka shënuar përparim të ndjeshëm në vlerësimet e OECD, falë politikave të përqendruara në qëndrueshmëri dhe agjendën e gjelbër:

1. Raporti i parë – OECD Competitiveness Outlook 2024:
 - Shqipëria ka përmirësuar pikëzimin e saj në dimensionin e politikave mjedisore;
 - Politikat e ndërmarra po japin rezultate të matshme në nivel ndërkombëtar.
2. Raporti i dytë – për mikro, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (MSME):
 - Ka filluar përgatitja për vlerësimin e vitit 2025, me publikim në 2026;
 - Një nga dimensionet kryesore të raportit do të jetë aksesin në financa të gjelbra dhe përfshirja e MSME-ve në tranzicionin klimatik.
3. Raporti i tretë – OECD Scoreboard for Convergence (2023):
 - Vlerëson të gjitha politikat e vendeve të Ballkanit Perëndimor në raport me konvergencën ndaj BE-së;
 - Shqipëria është vendi i parë për sa i përket zhvillimit të politikave të gjelbra, një fakt që tregon përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim.

Ndërgjegjësimi dhe Pjesëmarrja e Bizneseve

- Znj. Hudhra theksoi se pavarësisht se politikat ekzistojnë dhe janë të strukturuar, ndërgjegjësimi i aktorëve ekonomikë mbetet i ulët.
- Nëse bizneset nuk janë të informuara dhe të përfshira, fushatat dhe politikat nuk prodhojnë efektin e dëshiruar.

Përfitimi nga Fondet e BE-së

- Shqipëria aktualisht është në një moment shumë të favorshëm për të përfutuar fonde të mëdha, përpara se të bëhet anëtare me të drejta të plota në BE.
- Single Market Programme, që fokusohet në konkurrueshmëri dhe përfshirje të komponentit të gjelbër, është një nga programet më premtuese.

Mbështetje Praktike për Bizneset

- MEKI, me mbështetjen e GIZ, ka përfunduar hartimin e një udhëzuesi të detajuar për të gjithë aktorët, në veçanti për bizneset, që i ndihmon ata të kuptojnë si të aplikojnë në programet e BE-së për financim të gjelbër.
- Ky udhëzues është publikuar në faqen zyrtare të MEKI dhe do të shoqërohet nga një sesion i madh informues, ndjekur nga workshope teknike, të cilat do të ndihmojnë aplikantët në mënyrë praktike dhe të drejtpërdrejtë për përgatitjen e propozimeve.

Zj. Daniela Ndrejaj

Znj. Daniela Ndrejaj, në emër të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), ndau progresin dhe sfidat që institucioni ka hasur në promovimin dhe integrimin e aspekteve klimatike në tregjet financiare jo-bankare në Shqipëri.

Ajo theksoi gjithashtu rëndësinë që AMF i kushton ndërtimit të kapaciteteve të tregut për të kuptuar dhe aplikuar mekanizmat e financimit të qëndrueshëm. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) ka qenë aktiv në promovimin dhe integrimin e aspekteve klimatike në sektorin financiar, në përputhje me prioritetet e Strategjisë së AMF-së 2023–2027. Fokus i veçantë i është kushtuar krijimit të një kuadri që mbështet investimet e qëndrueshme dhe nxit emetimin e instrumenteve financiare miqësore me mjedisin, përfshirë obligacionet e gjelbra.

AMF ka ndërmarrë një sërë iniciativash konkrete, si:

- Organizimi i konferencave të dedikuara për financat e gjelbra, në bashkëpunim me SEK dhe Bankën Botërore;
- Promovimi i standardeve ndërkombëtare, si EU Green Bond Standard, si hap drejt krijimit të një kuadri të harmonizuar për financimin e qëndrueshëm;
- Nxitja e emetimit të obligacioneve të gjelbra në tregun vendas, si pjesë e objektivave strategjike për periudhën 2023–2027;
- Ndërgjegjësimi i tregjeve financiare, industrisë së sigurimeve dhe fondeve të pensioneve mbi rreziqet klimatike dhe rëndësinë e përfshirjes së kriterëve ESG (Mjedis, Shoqëri dhe Qeverisje);
- Integrimi i obligacioneve klimatike dhe aspekteve të qëndrueshmërisë në politikat rregullatore dhe mbikëqyrëse.

Ndërhyrja e saj theksoi se zhvillimi i tregut të gjelbër të kapitaleve në Shqipëri është në faza të hershme, por po ndërmerren hapa të rëndësishëm për të ndërtuar një infrastrukturë të besueshme, të matshme dhe në përputhje me praktikatat e BE-së dhe iniciativat globale për klimën.

Zj. Mirela Kamberi

Znj. Mirela Kamberi ndau përvojën e gjatë të UNDP në përgatitjen dhe mbështetjen e Shqipërisë në drejtim të politikave klimatike dhe raportimeve kombëtare. Ajo kujtoi se që në vitet 1993–1996 u përgatit dokumenti i parë lidhur me ndryshimet klimatike, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë që nga ratifikimi i Konventës së OKB-së për Ndryshimet Klimatike në vitin 1992.

Pikat kryesore të ndërhyrjes:

- Shqipëria ka përgatitur periodikisht inventarët e shkarkimeve të gazeve serrë, çdo 4–5 vjet, duke përmirësuar cilësinë e të dhënave dhe analizave.
- Janë identifikuar sektorët më të cenueshëm dhe potenciali i reduktimit të emetimeve, me qëllim hartimin e planeve të adaptimit dhe zbatimin e objektivave kombëtare për reduktimin e shkarkimeve nga sektoret kyç të ekonomisë.
- Dokumenti më i rëndësishëm në këtë drejtim është Kontributi Kombëtar i Përcaktuar (NDC) i përmirësuar në 2021 me asistencën e UNDP dhe FAO. Ndërsa Plani Kombëtar për zbatimin e tij është kuantifikuar me ndihmën e Bankës Botërore dhe përfshin objektiva të qarta për vitin 2030, në linjë edhe me Planin Kombëtar për Klimën dhe Energjinë.

Sfidat, Rekomandimet dhe Zhvillimet e së ardhmes

Në përmbyllje të diskutimit në tryzën e rumbullakët pjesëmarrësisht identifikuan sfidat aktuale:

- Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional – ndonëse ekziston një komitet ndër-institucional i udhëhequr nga Ministria e Mjedisit dhe Infrastrukturës, mungon koordinimi dhe dinamika në mbledhje dhe në ndjekjen e planit kombëtar.
- Monitorimi i objektivave është i dobët – Shqipëria ka plane të mirëstrukturuara, por nuk ka një mekanizëm funksional për të matur progresin real: “Ku jemi? A kemi arritur targetin? Pse jo?” janë pyetje që mbeten pa përgjigje të qarta.
- Sektorë problematikë përfshijnë efikasitetin energjetik, pyjet, bujqësinë, blegtorinë dhe mbetjet. Mungesa e koordinimit ndërmjet ministrive dhe projekteve të ndryshme e bën të vështirë ndjekjen e rezultateve.
- Kapacitetet institucionale – lëvizja e shpeshtë e stafit dhe mungesa e ekspertizës e bën të vështirë funksionimin e strukturave teknike për zbatimin e VKM-ve dhe planeve të raportimit.
- U theksua nevoja që universitetet, si Universiteti i Tiranës, të përfshihen më aktivisht në punën teknike dhe të bëhen pjesë e sekretariatit që ndihmon zbatimin dhe monitorimin e politikave klimatike.

Disa nga përfundimet e tryezës janë paraqitur në vijim:

- Për një tranzicion të suksesshëm klimatik dhe ekonomik, është e nevojshme jo vetëm të ekzistojnë politika të qarta, por edhe të sigurohet angazhim aktiv i bizneseve, ndërgjegjësim i publikut dhe koordinim ndërinstytucional i qëndrueshëm, në mënyrë që Shqipëria të vazhdojë të udhëheqë në rajon në fushën e zhvillimit të gjelbër.
- Rëndësia e sigurimeve ndaj katastrofave natyrore cilvsohet një mjet thelbësor për stabilitetin financiar dhe fiskal të vendit në kontekstin e risqeve klimatike në rritje.
 - statistikat rajonale janë dekurajuese: vetëm 12% e familjeve në Ballkanin Perëndimor janë të mbuluara nga një policë sigurimi për katastrofa.
 - Në rastin e Shqipërisë, situata paraqitet jashtëzakonisht heterogjene, me përqindje shumë të ulëta në shumicën e qyteteve (vetëm 1–1.5%), ndërkohë që në Tiranë, shkalla e penetrimit e kalon 63%.
 - Kjo diferencë nuk mund t'i atribuohet një faktori të vetëm; kultura financiare, niveli ekonomik, mungesa e informacionit dhe mosbesimi te produktet e sigurimit janë ndër faktorët që ndikojnë drejtpërdrejt.
- Madhësia e tregut është e kufizuar dhe për këtë arsye, duhet punuar paralelisht me të dy anët:
 - Ofruesit e sigurimeve, për të ndërtuar produkte më të besueshme dhe të aksesueshme;
 - Konsumatorët, për t'i kuptuar dhe vlerësuar këto produkte si mbrojtje e domosdoshme, jo si kosto e panevojshme.

Disa nga rekomandimet e tryezës janë paraqitur në vijim:

1. Strategjia Kombëtare dhe Koordinimi Institucional

- Rinovimi i objektivave kombëtare duhet të bazohet në vlerësime reale për progresin e arritur.
- Ministritë dhe donatorët duhet të koordinojnë përpjekjet për një qasje të bashkërenduar dhe të matshme.
- Është thelbësore të përcaktohen qartë "pikat fokale" dhe përgjegjësitë institucionale për raportim dhe zbatim.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe ndërtimi i kapaciteteve afatgjata janë kyç për të shmangur përpjekje të shpërndara dhe për të përmbushur objektivat.

2. Përforcimi i Sektorit Financiar dhe Mbikëqyrja

- Shqipëria ka nevojë për një strategji të qartë mbikëqyrëse për qëndrueshmërinë klimatike në sektorin financiar.
- Të zhvillohet një Strategji Kombëtare Mbikëqyrëse nga Banka e Shqipërisë dhe AMF.
- Të ndërtohen sisteme për monitorimin e riskut klimatik dhe analizën me skenarë.

- Të hartohen udhëzime për raportimin dhe menaxhimin e riskut klimatik.
- Të nisë një Plan Veprimi për Financat e Gjelbërta, me koordinim ndërinstitucional.
- Të zhvillohet një taksonomi e gjelbër kombëtare e përafruar me BE-në.
- Të krijohen kuadro ligjore për obligacionet e gjelbra dhe të lidhura me qëndrueshmërinë.

3. Financimi i Gjelbër dhe Akses për Sektorë Prioritarë

- Të zgjerohet aksesit në kredi të gjelbra, veçanërisht për bujqësinë dhe NMVM-të.
- Të mbyllet boshllëku në tregjet e sigurimeve përmes politikave rregullatore dhe partneriteteve publike-private.
- Të investohet në sisteme të të dhënave për hartëzim gjeohapësinor të risqeve dhe raportim të lidhur me emetimet.

4. Edukimi Financiar dhe Ndërgjegjësimi Publik

- Shqipëria duhet të investojë në edukimin financiar të konsumatorit, veçanërisht për sigurimet.
- Rritja e penetrimit të sigurimeve përmes edukimit dhe politikave fiskale stimuluese është e domosdoshme.

5. Menaxhimi i Risqeve Klimatike dhe Natyrore

- Të krijohet një Fond Kombëtar për Menaxhimin e Risqeve nga Fatkeqësitë.
- Të përdoren instrumente si catastrophe bonds dhe climate risk facilities.
- Të zgjerohet modelimi i riskut klimatik në analizat fiskale dhe strategjitë buxhetore.
- Të fuqizohet Këshilli Fiskal si një mekanizëm i pavarur vlerësimi.
- Të rritet transparenca përmes FSR-së dhe platformave dixhitale.

Përfundime të dokumentit të politikave

Diskutimet dhe rekomandimet e tryezës së rrumbullakët nxorën në pah një panoramë të qartë të sfidave sistematike, por gjithashtu edhe potencialin e madh që ka Shqipëria për të avancuar drejt një tranzicioni të suksesshëm klimatik dhe energjetik. Ndërsa objektivat afatgjata – si arritja e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050 – kërkojnë përpjekje të vazhdueshme dhe të ndërthurura në disa nivele, sfidat e tanishme lidhen ngushtësisht me boshllëqet në koordinim, kapacitete institucionale, mbledhje dhe përdorim të të dhënave, si dhe me ndërgjegjësimin e publikut dhe aktorëve ekonomikë.

Sfidat Kryesore

- Mungesa e një kuadri afatgjatë të integruar për reduktimin e emetimeve dhe menaxhimin e risqeve klimatike.
- Dobësitë në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe mungesa e një mekanizmi funksional për monitorimin e objektivave klimatike.
- Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe teknike për mbledhjen, analizën dhe raportimin e të dhënave klimatike dhe energjetike.
- Qasje e fragmentuar ndaj zhvillimit të tregut të sigurimeve për risqet klimatike, me diferenca të mëdha midis rajoneve.
- Mungesë edukimi financiar dhe kulturë të ulët siguri në popullatë.
- Paqartësi strategjike në zhvillimin e burimeve energjetike dhe përdorimin e tokës në raport me projektet energjetike.

Rekomandimet Kryesore

1. Hartimi i një kuadri të integruar politikash klimatike dhe energjetike, me objektiva të qarta, të matshme dhe të harmonizuara me angazhimet ndërkombëtare dhe BE-në.
2. Rritja e kapaciteteve institucionale, përmes trajnimeve të qëndrueshme, përfshirjes së universiteteve dhe ndërtimit të ekipeve teknike të qëndrueshme.
3. Zhvillimi i një strategjie mbikëqyrëse kombëtare për risqet klimatike, duke përfshirë:
 - Sisteme të avancuara për monitorimin dhe analizimin e risqeve;
 - Udhëzime për raportimin e riskut klimatik nga institucionet financiare;
 - Futjen e analizave të skenarëve klimatikë në vlerësimet fiskale dhe buxhetore.
4. Fuqizimi i financave të gjelbra përmes:
 - Krijimit të një taksonomie të gjelbër kombëtare të harmonizuar me BE-në;
 - Nxitjes së emetimit të obligacioneve të gjelbra dhe të lidhura me qëndrueshmërinë;
 - Ndërtimit të një “Green Finance Roadmap” me përfshirje ndërinstitucionale.
5. Zgjerimi i mbulimit me sigurime për katastrofat natyrore, përmes:
 - Politika fiskale stimuluese dhe edukim publik;
 - Krijimit të një Fondi Kombëtar për Menaxhimin e Risqeve nga Fatkeqësitë;

- Përdorimit të instrumenteve të tregut, si “catastrophe bonds” dhe “climate risk facilities”.
- 6. Transformimi dixhital i të dhënave klimatike dhe energjetike, përmes ndërtimit të sistemeve moderne për mbledhje, shkëmbim dhe analizë të të dhënave, në përputhje me politikat e BE-së.
- 7. Diversifikimi i burimeve të energjisë, duke përfshirë:
 - Reduktimin progresiv të përdorimit të qymyrit dhe rritjen e pjesëmarrjes së burimeve të rinovueshme në përzierjen energjetike;
 - Eksplorimin e potencialit të bioenergjisë dhe hidrogjenit;
 - Mbështetjen e komuniteteve energjetike dhe vlerësimin e opsioneve të energjisë bërthamore.
- 8. Ndërgjegjësim dhe edukim publik, veçanërisht në lidhje me:
 - Sigurimet klimatike dhe financimin e gjelbër;
 - Rolin e konsumatorit në tranzicionin energjetik dhe mbrojtjen nga risqet natyrore.